



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Në bazë të nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 16.2 dhe nenit 20, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) në lidhje me kontratën me numër të prokurimit: 632-22-9573-2-2-1, numër të brendshëm 632-22-097-221 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-26602, për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Autoritetit kontraktues: në bazë të kompetencave dhe përgjegjësisë ligjore, më dt. 04.05.2023, Zyrtari përgjegjës i prokurimit, Ju njofton:

NJOFTIM

Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

Neni 16, paragrafi 16.2 i KPK përcakton se “Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore”, dhe

Neni 20, paragrafi 20.1 i KPK përcakton se “Palët duhet t’i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën”

Ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 22.11.2022, me numër të prokurimit: 632-22-9573-2-2-1, numër të brendshëm 632-22-097-221 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-26602, me titull “Organizimi i festave tradicionale në Komunën e

Gjakovës'', ne mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të shërbimeve N.T.P. " LIVING STUDIO"rr."Tirana, p.n., Gjakovë, do te ndërpritet me marrëveshje mes dy palëve me date 05.05.2023.

Kontrata do te ndërpritet duke u bazuar ne nenin 16, paragrafi 16.2 dhe nenin 20 paragrafi 20.1, te Pjesa II e Kontratës – Kushtet e Përgjithshme.

Për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Autoritetit kontraktues, palët kontraktuese kanë arritur në përfundim që të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.

Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëmshpërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.

Shkresës i bashkëngjiten kërkesa e Operatorit ekonomik dhe rekomandimi i Menaxherit të kontratës për shkëputje të kontratës.

Me respekt,

Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

<i>Data/nr</i>	20.04.2023
<i>Për:</i>	Zyrën e prokurimit - Z.Faton Gutaj
<i>Nga:</i>	Menaxher i kontratës Organizimi festave tradicionale për KK-Gjakovë Alban Krasniqi
<i>Lënda:</i>	Rekomandim për kontratën : Organizimi i Festave Tradicionale

REKOMANDIM

Duke i'u referuar e-mail-it të dërguar nga Operatori Ekonomik " LIVING STUDIO " i cili ka kërkuar ndërprerjen e kontratës " Organizimi festave tradicionale " për KK-Gjakovë duke u bazuar në nenin 16.2 dhe nenin 20 të kontratës .

I lartëpërmenduri kërkon shkëputje të kontratës me Komunën e Gjakovës, arsyeja e shkëputjes së kontratës është vonesa e pagesave. Operatori Ekonomik i referohet nenit 16.2 i cili thotë se shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore. Poashtu, ai i referohet nenit 20 - zgjedhje miqësore të mosvarrëveshjeve.

Ju rekomandoj që të vazhdoni me procedurat për shkëputjen e kontratës .

Email-in e Operatorit Ekonomik e keni të bashkangjitur.

Me Respekt :

Alban Krasniqi.
Menaxher i kontratës

Venera Shtaloja

From: Alban I. Krasniqi
Sent: Thursday, April 20, 2023 1:54 PM
To: Faton Gutaj
Cc: Ardian Gjini; Nikoll Lleshi; Venera Shtaloja
Subject: Fw: Pershendetje

Përshendetje i nderuar,

Ju informoj që këtë javë kemi pranuar një email nga zt. Adhurim Haraqia operatori ekonomik " LIVING STUDIO " i cili merret me organizimin e festave tradicionale në komunën e Gjakovës.

I lartëpërmenduri kërkon shkëputje të kontratës me Komunën e Gjakovës, arsya e shkëputjes së kontratës është vonesa e pagesave .OE i referohet nenit 16.2 i cili thotë se shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarikë nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit.Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesa thelbësore. Poashtu, ai i referohet nenit 20 - zgjedhje miqësore të mosvarrëveshjeve.

E-mail e OE e keni te bashkangjitur.

Me Respekt :
Alban Krasniqi.

From: Adhurim Haraqia <adhurim.haraqia@gmail.com>
Sent: Friday, April 14, 2023 2:36 PM
To: Alban I. Krasniqi
Subject: Re: Pershendetje

Pershendetje Alban,

Uroj te jesh mire me shendet dhe me pune gjithashtu!

Po te shkruaj prap ne lidhje me email e meposhtem qe ti kam derguar disa jave me pare ne lidhje me kerkesen time per shkeputje te kontrates per arsyet e vonesave te pagesave qe kne qene rreth 4muaj me vonese.

Duke u bazuar ne arsyet e mia dhe NENIT 20 Puka 16.2 e kontrates te cilat I kam cekur me poshte kerkoj qe me mirekuptimin e dy anshem qe te shkepusim kete kontrate, ku as nuk jam duke kerkuar ndonje demshperblim, dhe as nuk pres nga ana juaj ndonje penalizim!
per cdo paqartesi dhe pyetje shtese lirisht me kontakto ne cdo kohe!

Cdo te mire,

Adhurimi!

On Fri, Apr 14, 2023 at 14:23 Adhurim Haraqia <adhurim.haraqia@gmail.com> wrote:

On Fri, Apr 7, 2023 at 10:06 Alban I. Krasniqi <alban.i.krasniqi@rks-gov.net> wrote:

Pershendetje sic kemi kontaktuar ne rrjete sociale " facebook " me datën: 03.04.2023 per faturën e fundit , me saktësisht koncerti Qamili i vogël data e situacionit eshte gabim, kërkoj nga ju qe te vini dhe ta bëni rregullimin e datës se faturës per arsye se fatura nuk mund te paguhet pa u rregulluar ky dokoment.

Pune te mbar .

From: Adhurim Haraqia <adhurim.haraqia@gmail.com>

Sent: Tuesday, March 21, 2023 7:23 PM

To: Alban I. Krasniqi <alban.i.krasniqi@rks-gov.net>

Cc: Valon Perolli <valon.perolli@rks-gov.net>; Venera Shtaloja <venera.shtaloja@rks-gov.net>

Subject: Re: Pershendetje

Pershendetje Alban,

Po ju shkruaj prap ne lidhje me email e meparshem te cilin ju kam derguar me dt 09.03.2023 mirpo nuk kam marrur asnje pergjigje nga ju!

Deri me sot me dt 21.03.2023 ende nuk eshte kryer komplet pagesa e fatures 098/22 e dt 19.12.2022 dhe faturat tjera te me vonshme.

Sipas ligjit te kontrates te cekur ne email-in paraprak kane kaluar te gjitha afatet ligjore per pagese ku kane kaluar me shume se 90dite dhe per kete arsye une kerkoj nga ju qe te procedoni sa me pare procedurat per shkeputjen e kontrates pasi qe keto vonesa jane te papranueshme dhe nuk kam mundesi qe te pres me gjate.

ju lutem me njoftoni se kur duhet te vije ne komune apo zyret tuaja per te kryer keto procedura.

cdo te mire,

Adhurimi

On Thu, Mar 9, 2023 at 6:36 AM Adhurim Haraqia <adhurim.haraqia@gmail.com> wrote:

Pershendetje Alban,

Uroj te jesh mire me shendet dhe me pune gjithashtu!

Jam Adhurim Haraqia nga kompania Adhurim Haraqia B.I.(Living Studio) me NRU810236150 kontraktues i Komunes se Gjakoves per kontraten me tutull **Organizimi i festave tradicionale ne Komunen e Gjakoves** me nr 632-22-9573-2-2-1-C643 te protokoluar me dt:22.11.2022

Po ju shkruaj ne lidhje me disa ankesa qe i kam nga ana ime ne raport me mbarevajtjen e kontrates se lartecekur.

1. Pas nenshkrimit te kontrates me dt:22.11.2022 une kam filluar menjeher me furnizimet e materialeve per realizimin e projektit sikurse ishte parapare ne kontrate. Me pas me eshte kerkuar nga menaxheri i kontrates Valon Perolli qe kontrata te realizohet pjeserisht per shkak te vendimit te Qeverise se Kosoves per kursimin e energjise elektrike, gje te cilen e kam mirekuptuar dhe jam pajtuar edhe pse kjo me shkaktonte ngarkes financiare per shkak qe isha ngarkuar me stok te cilin e kisha blere pas nenshkrimit te kontrates duke u bazuar ne kerkesen qe ishte ne kontrate.

2. Vlera e fatures per sherbimet e kryera ka qene 32070.00 euro, mirpo me kerkese te Valonit dhe Fisnikut kolegut tuaj me eshte kerkuar qe te faturohet vetem pjesa 28620.00euro, ndersa mbetja e fatures ne vlere prej 3450.00euro te shtyhet per ne fillim te vitin 2023 (ne faturen e fundit ishin te perfshira fishekzjarret, montimi/demontimi i shtepizave dhe 3ylla shtese qe kishte qene kerkese nga ana juaj).

Kjo kerekese per shtyerje te faturimit ishte bere me arsyetimin qe nuk ishte perfunduar pjesa e fishekzjarreve dhe nuk mund ta pranoin faturen, edhe per kete kerkese kam pasur mirekuptim edhe pse ka qene e pa arsyeshme.

Menjeher ne fillim te muajit Janar kam shkuar per ta dorezuar kete fature te mbetur dhe me eshte kerkuar qe te shtyhet edhe pak per shkaqe te procedurave te cilat akoma nuk i kam te kjarta pasi qe puna ishte

perfunduar dhe nuk kishte arsye te mos pranohej fatura... dhe kjo shtyerje eshte bere deri ne dt 06.02.2023 kur eshte pranuar kjo fature (dhe nuk eshte paguar ende)

Si perfundim, nga totali i vleres se puneve te kryera ne muajin Dhjetor 2022 qe ishte 32070.00 euro pagesa jene kryer vetem 16470.00 euro dhe pothuajse tash e tre muaj nuk eshte mbyllur pjesa e mbetur prej 15600.00euro, gje e cila me ka shkaktuar deme te medha financiare.

Duke ju referuar kontrates se lartecekur dhe **Nenit 16 'Parimet e pergjithshme te pagesave'** dhe pikes **16.2** **Ku thuhet: shumat duhet te paguhen brenda jo me shume se 30ditesh kalendarik**, at'her une si Operator ekonomik kerkoj qe keto pagesa te mbetura ne vlere prej 15600.00 euro te perfundohen max deri me dt 20.03.2023 ose ne te kunderten kerkoj pezullimin e kontrates se lartecekur me arsyetimin se keto vonesa te paarsyeshme jane te papranueshme nga ana ime.

Bashkangjitur gjeni edhe kontraten.

Per cdo pakjartesi ose pyetje shtese lirisht mund te me kontaktoni ne cdo kohe!

Cdo te mire,

Adhurimi